



Konkursi i Studentëve FED _ UBT 2021

Titull :

**Zhvillimi Rural dhe fuqizimi i sipërmarrjeve ka nevojë për
profesionistët e rinj**

Përgatitur nga Komisioni Organizativ i Konkurseve FED _ UBT (KOK)

Tiranë, Mars 2021.



NË VEND TË HYRJES

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis **Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe FED Invest**, të dy institucionet materializojnë aktivitetin e parë të përbashkët që synon ti japë udhë bashkëpunimit në funksion të objektivave të përbashkëta të dy institucioneve, por edhe mbështetjes së sektorit të zhvillimit rural në tërësi.

Organizimi i konkursit Zhvillimi Rural ka nevojë për profesionistët e rinj, i pari i këtij lloji dëshmon rëndësinë që dy institucionet i japin promovimit të të rinjve si një faktor determinant i zhvillimit të bujqësisë dhe agrobiznesit në tërësi, por edhe një kontribut i vyer për përafrimin e të rinjve me sektorin si edhe rritjen e kapaciteteve menaxheriale dhe konsolidimin e kapitalit human në funksion të zhvillimit sektorial dhe kombëtar.

RRETH FED

Përfaqëson sot një prej institucioneve të tregut financiar kredibel në vend, misioni i së cilës është të ofrojë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare, veçanërisht për popullsinë që jeton në zonat rurale të Shqipërisë, me qëllim rritjen e përfshirjes financiare dhe reduktimin e përgjithshëm të varfërisë. FED invest është një model i suksesshëm kooperimi i fermerëve shqiptarë prej gati 30 vitesh, në pronësi të tyre dhe aktualisht ka rreth 75 mijë anëtarë të cilët shërbehen nga një rrjet prej 60 degëve në të gjithë Shqipërinë, në zonat urbane dhe rurale. Është një numër shume i madh historive të suksesit të anëtarëve të FED invest, fermerë dhe sipërmarrës të vegjël, që kanë ngritur dhe zhvilluar aktivitetin e tyre, nga një nivel micro në aktivitete dhe biznese të qëndrueshme.

Qendra ABA dhe platforma e saj www.abaonline.al është krijuar si një iniciative e FED invest në bashkëpunim me JICA (Agjencine Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar) për të ofruar shërbime jo-financiare tek fermerët dhe të gjithë aktorët dhe faktorët në sektorin e bujqësisë në Shqipëri me qëllim informimin e fermerëve për teknologjite dhe te rejat për prodhimet në bujqësi dhe blegtori dhe të cmimeve të tregut të prodhimeve, si dhe të krijojë një platformë interaktive ku shkëmbehen mendime të fermerëve dhe ekspertëve dhe të gjithë anëtarët kanë mundësi të promovojnë, shesin dhe blejnë produkte bujqësore dhe të krijojnë lidhje të biznesit.



RRETH UBT

UBT është universiteti më i vjetër në Shqipëri, themeluar më 1 Nëntor, 1951. UBT konservon në mënyrë të kujdesshme vlerat e tij akademike, sikundër tregohet ambicioz në strategjitë zhvillimore dhe ato të kërkimit, kualifikimin e vazhdueshëm të stafit, ritjen e bashkepunimit ndërkombëtar dhe institucionalizimin e marrdhënive me biznesin.

UBT është një qendër unike e arsimit të lartë në Shqipëri konsideruar fushat e studimit të cilat ajo mbulon. Fokusi i veprimtarisë së tij është edukimi, kërkimi shkencor dhe transferimi i njohurive. Duke qenë qendra më e madhe e arsimit dhe kërkimit në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, UBT ka qenë në ballë të krijimit të lidhjeve midis shkencës dhe prodhimit. Këto lidhje janë materializuar nëpërmjet dhjetra e marrëveshjeve të nënshkruara aktorë publikë dhe në mënyrë të veçantë me komunitetin e biznesit shqiptar.

Universiteti Bujqësor i Tiranës konsiderohet sot si një nga institucionet më kredibël në sistemin universitar në vend. Ai qëndron në këtë pozicion për shkak të traditës së konsoliduar, stafit akademik të kualifikuar dhe serioz si edhe infrastrukturës e shërbimeve që shtohen dita ditës.

NEVOJAT PËR KËTË ORGANIZIM

- nevojë për një sinergji të re të zhvillimit midis të gjithë aktorëve të zhvillimit bujqësor dhe jo vetëm
- nevojë për aktivizim të profesionistëve të rinj në aktivitete që promovojnë ata dhe mbështesin të ardhmen e tyre,
- nevojë për zhvillim aftësish, njohurish, dhe kapacitetesh të kapitalit human
- nevojë për bashkëpunim të të gjithë aktorëve në sistem akademi/organizata biznesi/organizata financiare/organizata publike etj,
- nevojë për aplikim të teknikave, teknologjive të reja dhe risive
- nevojë për demonstrim dhe transferim të njohurive tek biznesi dhe fermerët
- nevojë për financim dhe mbështetje të zonave rurale



PSE TE APLIKONI

- ky konkurs përfaqëson një mundësi të provoni vehten në një mjedis përtej atij të grupit/kursit
- përfaqëson një oportunitet për një eksëriencë praktike në një institucion dinjitoz të fushës së bujqësisë
- zhvillon aftësitë dhe cilësitë tuaja profesionale
- hap një dimension të ri për karrieren tuaj profesionale

FAZAT KRYESORE

Konkursi i pari i këtij lloji dhe dimensionit në vend do të kalojë në këto faza:

1. Shprehja e interesit për pjesëmarrje
2. Kualifikimi paraprak
3. Mentorimi dhe zhvillimi i ideve dhe projekteve me profesoratin
4. Kualifikimi final dhe shpallja e fituesve

ÇMIMET DHE STIMUJT

- **Stimuj materialë (laptop, smart phone, tableta) Gjithësej 10 çmime**
 - ✓ Çmimi i parë: 1 lap top (ekujvalent deri në masën 700 euro); 1 çmim
 - ✓ Çmimi i dytë, 1 smart phone (ekujvalent deri në 500 euro çmimi); 3 çmime
 - ✓ Çmimi i tretë, 1 tablet (ekujvalent deri në 300 euro çmimi); 3 çmime
 - ✓ Çmimi i karrierës dhe internshipit, 5 çmime (praktike e kontraktuar dhe mundësi punësimi për çdo çmim)
- Publikimi i punimeve studentëve ne platormat e institucioneve tona **UBGreen.al dhe ABA online**



- Punimet e studentëve mund të përdoren për punimet e diplomës së tyre në rastin kur janë në vitin e fundit
- Mund të vazhdojnë një program “intershipi” në FED invest
- Publiciteti që do të krijohet në eventin që do të shpallen fituesit

DATA TË RËNDËSISHME

Faza	Përshkrimi i secilës fazë	Data
1	Shpallja e thirrjes publike	29.03.2021
2	Afati i fundit për shprehjen e interesit	13.04.2021
3	Kualifikimi paraprak	21.04.2021
4	Mentorimi i studentëve dhe zhvillimi	30.04.2021
5	Kualifikimi final dhe shpallja e fituesve	21.05.2021
✓	Zhvillimi i eventit final të ndarjes së çmimeve	28.05.2021

KRITERET E PERZGJEDHJES

Kriteret bazë të përzgjedhjes janë hartuar dhe zbatohen nga KOK (UBT_FED).

Gjetë fazes së parë të parakualifikimit ato do të jenë:

NR.	Kriteret	Pikët
1	Përputhshmëria me tematikat e shpallura të studimit	10
2	Niveli i pasqyimit të realitetit	10
3	Inovacione dhe risi	10
4	Rigoroziteti akademik dhe profesional për çdo kategori aplikimi	10
5	Përdorimi i literaturës dhe praktikave të mira	10
	Totali (max)	50



CFARË TË PËRGATSNI

Studentët duhet të përzgjedhin varësisht tematikave dhe ideve që ata kanë një nga format e mëposhtme për konkurim:

- **Projekt investimi**, (project proposal) në sistemin e agrobiznesit (industria e inputeve, sektori i fermës, industria agroushqimore)
- **Artikull** (kërkimor ose aplikativ)
- **Rast Studimor (një shembull suksesi)**
- **Ese**

TEMAT KRYESORE

Nr.	UBT/Fakulteti	Tematika
1	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	Shërbimet financiare në ferma dhe sistemin e agrobiznesit
		Sipërmarrja dhe menaxhimi i agrobizneseve
		Teknologjia e informacionit në AGB dhe fermt komerciale
		Menaxhimi i turizmit rural dhe agroturizmi
		Politikat bujqësore, menaxhimi i zinxhirit të vlerës
2	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	Agromjedisi, ekologjia dhe sfidat e se ardhmes
		Hortikulture dhe mbrojtje bimesh; teknologji dhe problem
		Peizazhi rural dhe problemet e lidhura me te
3	Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	Teknologjite e prodhimit të ushqimeve dhe siguria ushqimore
4	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare	Shëndeti i kafsheve të fermës dhe siguria veterinare
5	Fakulteti i Shkencave Pyjore	Inxhinieringu pyjor dhe perpunimi i drurit

NA KONTAKTONI....

Adresa 1: akercuku@ubt.edu.al; Adresa 2: eramadhi@fedinvest.al, eshehi@fedinvest.al